



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.4164/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Blaca-Dula, kryetare, Gëzim Lulluni dhe Halide Reka, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.B. nga ..., Komuna Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. S.B. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - Obiliq, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. N.M. nga Prishtina, për kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1177/19 i datës 02.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 12.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Obiliqit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Obiliq, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1177/19 i datës 02.12.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar .nr.1177/19 i datës 02.12.2019 ka vendosur:

“Aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit I.B. nga ..., Komuna Fushë Kosovë dhe detyrohet e paditura Komuna Obiliq, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Obiliq, që paditësit t’ia paguaj borxhin në emër të tri pagave jubilarë sipas mesatares së tre pagave të fundit në shumë prej 659,00€, e në shumë të përgjithshme prej 1,977.00 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit gjegjësisht prej datës 02.12.2019 e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 269 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.”

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën e të paditurës në tërësi si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar ashtu që të refuzohet kërkesëpadia që i përket kompensimit të dy pagave jubilarë, ose ta prishë aktgjykimin e lartcekur dhe të njëjtin ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I.B. nga ..., Komuna Fushë Kosovë, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi me datë 18.04.2019, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Obiliq, dhe në seancën përgatitore ka bërë precizimin e kërkesëpadiës me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë në emër të kompensimit për shpërblimit jubilar shumë të totale prej 1.977.00 €, me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, përmes të përfaqësuesit të saj, në seancën përgatitore e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi ka krijuar përvojë të punës në kohëzgjatje prej 27 vite në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, prandaj ka qenë e drejtë e paditësit që në të njëjtin institucion ku ka punuar më herët ti kërkoj dy paga jubilarë, gjatë kohës sa ka punuar, ndërkaq pagën e fundit jubilarë ta marrë përsipër Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Obiliq, andaj kërkoj nga gjykata që kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar lidhur me dy pagat jubilarë, ndërsa jemi të gatshëm të marrim përsipër një pagë jubilarë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe atyre të nxjerra në seancat e mbajtura gjyqësore si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1177/19 i datës 02.12.2019 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara dhe nga deklaratat e palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar faktin se nga kontrata e punës me nr. 07 e dt. 06.01.2016 e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit, rezulton se paditësi është në marrëdhënie pune me detyra dhe përgjegjësi të punës si doktor – radiolog në kohë të pacaktuar në QKMF në

Obiliq. Ndërkaq nga librezat e punës nr. 62/88 e dt. 03.12.1980, gjykata vërtetoi se nga marrëdhënia e punës paditësi ka 27 vite e 29 ditë përvojë pune në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq. Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, për lartësinë e kompensimit për pagat jubilarë gjykata e mbështeti në listën e pagave që ka realizuar paditësi, nga e cila konstatohet se paga e të njëjtit ka qenë 659,00 €, pasi që sipas Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë të dt. 11.06.2018, në nenin 17 të saj është paraparë “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, që për 30 vjet të përvojës së punës, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.” ashtu që, të njëjtit i takon shpërblimi jubilar në lartësi të tri pagave mujore të tij në shumën prej 1.977.00€ për shkak se paditësi ka përvojë pune 30 vite dhe se e paditura duke mos kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e tri pagave të shpërblimit jubilar. Për bazën juridike i është referuar dispozitës së nenit 17 par.3, pika 3.3, dhe par. 4 të Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë, e datës 11.06.2018 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë dhe nenin 4 par. 3 të Ligjit të Punës dhe nenit 246 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me kamatën iu referua nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditësit i takon e drejta në tri paga mujore të tij në emër të shpërblimit jubilar në shumën e gjykuar ngase është vërtetuar se nga librezat e punës nr. 62/88 e dt. 03.12.1980, u vërtetua fakti se paditësi ka 27 vite e 29 ditë përvojë pune në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, ndërkaq i njëjti punon tek e paditura si doktor – radiolog në kohë të pacaktuar në QKMF në Obiliq bazuar në kontratën e punës me nr. 07 e dt. 06.01.2016 e që rezulton se i njëjti ka mbi 30 vite përvojë pune në institucione shëndetësore e që vazhdon ende të punojë tek e paditura, andaj sipas Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë parashihet se: punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i

fundit në vlerë: për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij, ndërsa lartësia e pagës së paditësit është vërtetuar nga lista e pagave të realizuara nga paditësi në të cilën vërtetohet se lartësia e pagës mujore ka qenë 659,00€.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpërblim jubilar për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me dispozitën e nenit 17 paragrafi 3 të Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë të dt. 11.06.2018, përcaktohet se: *“3. Punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy page mujore të tij, 3.3. për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.”* Ndërsa në paragrafin 4 përcaktohet *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.”* Andaj me të drejtë iu është njohur shuma prej 1.977.00 € në emër të tri pagave për shpërblim jubilar, nga punëdhënësi i fundit, në këtë rast e paditura.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelsinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, konform nenit 194 të LPK-së si dhe kjo gjykatë i morri parasysh të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe, se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ac.nr. 4164/20, me datë 12.01.2021

Kryetarja e kolegjit
Nora Blaca-Dula, d.v.